

Vrasja mbrëmë në Prishtinë, nga Prokuroria thonë se ndërmarrin masat e nevojshme hetimore



26/03/2025 11:14



Një person ka mbetur i vdekur dhe një tjetër i plagosur, si pasojë e të shtënave me armë zjarri mbrëmë në Prishtinë.

Lajmin për këtë e ka konfirmuar mbrëmë edhe Policia e Kosovës, shkruan lajmi.net.

“Sot rreth orës 22:30, kemi pranuar informatën për të shtëna me armë në rrugën “Rrustem Hyseni” në Prishtinë, ku dysohet të jenë lënduar dy persona të cilët janë dërguar për tretman mjekësor. Aktualisht hetuesit policor janë duke ndërmarr të gjitha masat e nevojshme në lidhje me rastin dhe janë në kërkim të personit të dyshuar i cili tashmë është identifikuar”, ka thënë zëdhënësja e Policisë në Prishtinë, Flora Ahmeti.

Përmes raportit 24 orësh të Policisë, është thënë se të dyshuarit kanë qenë të armatosur e me maska.

“**Prishtinë 25.03.2025-22:25.** Raportohet se dy persona të armatosur dhe të maskuar kanë shtënë me armë zjarri në drejtim të dy viktimave meshkuj kosovarë dhe si pasojë njëri nga viktimat ka ndërruar jetë në QKUK, ndërsa viktima tjetër gjendet në tretman mjekësor. Në vendin e ngjarjes kanë dal të gjitha njësitet përkatëse policore. Me vendim të prokurorit, trupi i pajetë i viktimës dërgohet në IML për obduksion”, thuhej në raport.

Lajmi.net ka dërguar pyetje në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, të cilët kanë thënë se po e hetojnë rastin.

“Lidhur me pyetjen tuaj ju njoftojmë, se Prokurori i shtetit në bashkëpunim dhe koordinim me Policinë e Kosovës është duke ndërmarrë masa dhe veprime të nevojshme hetimore mbi këtë çështje”, ka thënë Prokuroria Themelore në Prishtinë.

Viktima e këtij rasti, sipas mjekut kujdestar në Emergjencë Agron Çitaku, gjysmë ore pasi është dërguar aty ka ndërruar jetë.


“Rreth orës 22:35 ka ardhur personi i parë i plagosur, ka qenë thuasje pa shenja jete. Është bërë reanimi i tij, për gjysmë ore, ka ndërru jetë. Pas 15 minutave ka ardhur i plagosuri tjetër që ka tri plagë por është në gjendje stabile. Personi që vdiq është rreth të 60-ave”, ka thënë Çitaku.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LajmiMedia



Artikuj të ngjashëm



March 26, 2025
4 vrasje brenda tri dite në Kosovë – Ekspertët e sigurisë:...



March 26, 2025
Mashtrimi ndaj Kurtit, Krasniqi: Përfaqësimi me “dinjitet”, del të jetë i...



March 26, 2025
Rrengu i rusëve ndaj Kurtit, Kica-Xhelili: E paskam pas gabim, diplomacia...



March 26, 2025
Haradinaj me ironi ndaj VV: Ata që e shkatërruan Kosovën 20...

LAJME TË FUNDIT

4 vrasje brenda tri dite në Kosovë –...

Mashtrimi ndaj Kurtit, Krasniqi: Përfaqësimi me “dinjitet”, del...

Rrengu i rusëve ndaj Kurtit, Kica-Xhelili: E paskam...

Haradinaj me ironi ndaj VV: Ata që e...



Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information